



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2302/1 Prot.

Tiranë, më 11.09. 2024

VENDIM

Nr. 56 dt. 11.09. 2024

PËR

HAPJEN E THIRRJES PËR VETËKANDIDIM TË ANËTARIT TË BORDIT TË
ADMINISTRIMIT, PËRFAQËSUES I STAFIT AKADEMIK TË
UST-SË

Në zbatim të nenit 38 pika 1 (gërma gj), nenit 47, 48 pika 1 dhe 6, 50 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, nenit 20 (gërma ll) si dhe nenit 42, 44 të Statutit të UST-së, Nenit 10 të Rregullores së UST-së, të Vendimit të Senatit nr.73, datë 27.09.2022 “Për zgjedhjen e anëtarit të Bordit të Administrimit në UST”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 11.09.2024

V E N D O S I :

1. Hapjen e thirrjes për vetëkandidim të anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i stafit akademik të UST-së, si pasojë e vakancës së krijuar nga mbarimi i parakohshëm i mandatit të 1 (një) anëtari të Bordit të Administrimit (thirrja bashkëlidhur).
2. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim Njësive Kryesore, Bordit të Administrimit dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2302 / Prot. 12

Tiranë, më 11/09 /2024

NJOFTIM

**PËR HAPJEN E APLIKIMEVE PËR ANËTAR TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS**

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL të Republikës së Shqipërisë”, nenit 48 të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, njoftohet personeli akademik i Universitetit të Sporteve të Tiranës, për mundësinë e aplikimit për:

1 (një) anëtar të Bordit të Administrimit, përfaqësues të personelit akademik të UST.

Vendi vakant i krjuar për anëtar të Bordit të Administrimit, i përket përfaqësuesve të personelit akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës.

Të drejtën për të aplikuar për anëtar të Bordit të Administrimit, përfaqësues të personelit akademik të UST, e kanë anëtarët e Asamblesë Akademike të UST, që i përkasin kategorisë “Profesor” dhe “Lektor” dhe janë në marrëdhënie pune me kohë të plotë në UST.

Afati kohor për paraqitjen e aplikimeve është nga data 12.09.2024, deri më 18.09.2024, ora 08:00 deri në orën 15:00.

Aplikimi realizohet përmes vetëkandidimit dhe shoqërohet me dokumentacionin si vijon:

1. Kërkesë me shkrim të aplikantit.
2. Kopje të Letërjnjoftimit (ID) ose Pasaportës..
3. Kopje të Diplomës së titullit akademik ose të gradës shkencore.
4. Formular vetëdeklarimi, (shtojca 1) bashkëlidhur.

Aplikimi(dosja), dorëzohet në Zyrën e Protokollit të UST-së.

KRYETAR I SENATIT
Prof.Dr. AGRON KASA



Shtojca:1

FORMULAR VETËDEKLARIMI

“ Për hapjen e procesit për aplikim të kandidatëve për të zëvendësuar vendin e mbetur vakant në Bordin e Administrimit (BA), në Universitetin e Sporteve të Tiranës

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Mbiemri, Emri	
Atësia / Mëmësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokument identifikimi (një kopje bashkëngjitur këtij formulari)	
Data dhe ora e regjistrimit në sekretariat	
Personel Akademik në Njësinë Kryesore	Fakulteti _____

Deklaroj me vullnetin tim te lire se jam: - i/e padënuar - i/e dënuar

DEKLARUESI

MARRËSI I VETËDEKLARIMIT

Sekretar i Senati Akademik

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta, dhe vetëkandidimi im është konform kriterëve të shpallura në faqen zyrtare të UST-së dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga UST / MAS.